

VENDIM
Nr.806, datë 22.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.646, DATË 30.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri limit i punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në qarqe, të jetë, gjithsej, 739 veta.”.

2. Në lidhjen nr.3, të përmendur në pikën 2, në sektorin e PMNZSH-së, së qarkut Kukës, të shtohet stacioni i policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në tunelin Thirrë-Kalimash, me këtë përbërje:

“Stacioni i policisë i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në tunelin Thirrë-Kalimash

- Shefi i PMNZSH-së, për objektin, oficer, 1 (një);
- Komandant stacioni, oficer, 1 (një);
- Komandant turni, polic, 4 (katër);
- Shofer zjarrfikës, polic, 17 (shtatëmbëdhjetë);
- Zjarrfikës/shpëtues, polic, 27 (njëzet e shtatë).”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha